

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në udhëzimin nr. 499, datë 2.7.2019 “Për procedurat e pranimi dhe emërimit të mjekëve në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet platformës elektronike”, botuar në Fletore Zyrtare nr. 109, datë 26.7.2019, në pikat 2 dhe 3, të kreut V “plotësimi i vendeve vakante nëpërmjet programit të bonusit”, bëhet korrigjimi i gabimit material si vijon:

Ishte:

“2. Kandidatët që aplikojnë në Programin e Bonusit duhet të jenë të punësuar në institucionet shëndetësore publike.

3. Për aplikim nevojitet:

- a) kërkesa për shprehje interesi;
- b) vërtetimi i punësimit nga institucioni shëndetësor ku punon, si dhe leje nga institucioni për pjesëmarrje në Programin e Bonusit;
- c) diploma e specialitetit.”

Bëhet:

“2. Kandidatët që aplikojnë në Programin e Bonusit kur janë të punësuar në institucionet shëndetësore publike, duhet të marrin leje nga institucioni ku punojnë për pjesëmarrje në Programin e Bonusit.

3. Kandidatët që aplikojnë në këtë program, përveç dokumenteve sipas pikës 6, të kreut I, duhet të dorëzojnë dhe vërtetim nga njësia administrative për vendbanimin;”